- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë pér Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsyet t'ë justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit pér përm bushje të konratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa pér kryerjen e aktivitetave të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë pér shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Konratës do të rregullohet po ashtu.

## PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

### Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë pér verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

### Neni 32 Testet pér përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues pér datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e konratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkësës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet pér pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, pér një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme pér pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje pér Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me konratën dhe janë të gatshme pér pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi pér ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më pér përdorim përkitazi me realizimin e konratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në konratë.

## Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinvimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinvimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinvim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- të ndërpresë konratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

## Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas konratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas konratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitive të konratës.

## SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

### Neni 36 Shkelja e konratës

36.1 Pala ka shkelë konratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me konratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e konratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/ose
- ndërpërjen e konratës.

36.3 Përveç masave të sipërpermendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### Neni 37 Shkëputja e konratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Konratës.

37.2 Shkelja themelore e konratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërpërje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyet e justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e konratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e konratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të konratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e konratës paraqet bazë për shkëputje të konratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijojen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të konratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marjes së njoftimit me shkrim për ndërpërje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërsimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me konratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të konratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërpërjen e konratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdheshimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirim i ngjarjeve e Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kérkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kérkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kérkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kérkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-10149-5-2-1/C1076

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shenimet kurative të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Pershkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksi i do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [Shqipe].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së Kontratës në kohëzgjatje deri 120 ditë, apo shprehur nominalisht, 5.417.58€.
Përgjegjësia dhe i Sigurimi Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës përkujdesjen e tyre, përfundimisht arsyesh, përpunuar sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkeshave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 ditë pas nëshkrimit të kontratës
	17.2	<p>Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë për 90 ditë Kalendarike rrespektivisht deri më : 12.10.2025</p> <p><b>Data e përfundimit të punëve të parapara me këtë kontrate, nuk duhet të jetë më larg se 12.10.2025.</b></p>

		<b>Çdo tejkalimi, ose mosrespektim të KPK dhe KVK, konsiderohet shkelje e afateve kohore përfundimin e punëve dhe do të ekzekutohen penalet sipas pikës 19.1, të KVK-së.</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara përfunduar përfundimtar të Kontratës përfundimtar  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara përfunduar përfundimtar është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Me rastin e fillimit të punëve kontraktuesi është i obliguar të hapë ditarin e punës i cili do mbahet rregullisht.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit Caktohet: 1. Enver Elshani-kryesues 2. Besart Zejnullahu - anetar 3. Rinor Hajrizi caktohet MDMK
Pagesa	26.1	<b>Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuara nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur përsesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas leshuarjes se Certifikates se Pr Koheshme te Pranimit.</b>  Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOSSHËM të punëve, njashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR, sipas manualit-doracakut të KRPPsë, i publikuar më dt 08.07.2024
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancinë mbi kualitetin e punimeve 10% te vlerës se kontratës per 12 muaj i cili do te përdoret përmirësim te defekteve nëse paraqiten gjatë kohës së gradacionit, nëse OE nuk përgjigjet Autoritetit kontraktues për eliminimin e defekteve të paraqitura, do të bëhet konfiskimi i sigurimit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin përfundimtar e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	39.2	Palët Kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e dispozitiveve të kësaj kontrakte të zgjedhin me marrëveshje. Afati përzgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kontraktuese pajtohen që të jetë 15 ditë nga dita e paraqitjes së kontestit.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra per Ndermjetesim prane Ministrise se Drejtësise
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrakte dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykata themelore e vendit në pajtim me ligjin në Kosovë.  ose  b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrakte dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Rikonstrukturimi ndriçimit publik në fshatin Janjevë					
Pos	Pershkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Gjithsej me TVSH
1	<b>PUNET PARAPRAKE NE TEREN</b>				
1.1	Shenimi i trasesë, si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m <sup>2</sup>	3,500.00	0.50	1,750.00 €
1.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë zhvillimit të punimeve përgjat trasese .	m <sup>2</sup>	3,500.00	0.50	1,750.00 €
				gjithsej	3,500.00 €
2	<b>PUNËT E NDRIÇIMIT</b>				
	Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të janë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e qualitetit dhe të standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. OE është i obliguar qe t'i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të janë plotësisht të njëjtë me të dhënat teknike të përkruara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikaten e origjinës së materialeve.Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet tia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës pë Verifikim dhe Evaluim.				
2	Rikonstrukturimi ndriçimit publik në fshatin Janjevë				
	Pershkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Gjithsej me TVSH
2.1	Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriçimit KESHN nga materiali i metallit i ngjyrosur me ngjyrë antikorodive me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës trekëndësh (univerzal).. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozioni. Kuadri duhet të përbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente: 1. Njehsorin elektrik trefazor digital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarifor 3x230/400V; 50Hz I miratuar nga MTI 2. Ndërpresin automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A 4. Siguresat automatiqe katërpolare 32A ; - " " 16A ; - " " 6A 5. Kontaktör për kyçje automatiqe të ndriçimit C-44 ,40A,380V 6. Releun kohore digital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriçimit ,me bazhdarim me kohë.dhe kyçje me errësirë. 8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në fazë 9. Prizën njëpolare për shërbime e servisime brenda kuadrit 10. Llambën ndiquese të brendi të kuadrit 11. Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përquesve në fazë, zbarren e përquesve të zeros dhe zbarren e përtokzimit, 12. Shkarkuesit katodik dhe zbarren për barazimin e potencialit.13.Siguresat thikore 63 A ,3 copë; Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të janë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriçimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elemnteve duhet të behet ne baze te skemes njekahore e kuadrit shperndares.	copë	2.00	510.00	1,020.00 €
2.2	Ndërtimi i bazamentit të betonit për KKSH të ndriçimit me dimenzione 80x90x30cmx1	m <sup>3</sup>	0.44	60.00	26.40 €

2.5	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 50E me llupë.Llampa nga aspekti i dizajnit duhet ti plotësojë standartet Europeane, EN 60598-2-3,EN 55015 DHE TË KETË; Mbrotje : IP65(IP66).Qëndrueshmëri pune :≥50000(h) Efikasitet ndriçueshmërisë së LEDIT-IT≥125LM/ë Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:≤5000K Tension pune :90...270V (50Hz) Faktor të Fuqisë:≥0.92 Temperaturë pune:(-40...+60)°C Mbrotje nga goditja:IK10 Garacion :≥ 5 vite.	copë	110.00	125.00	13,750.00 €
2.6	Furnizimi dhe montimi i kabllosë furnizuese NAYY -AL-4X25mm <sup>2</sup> ,për furnizim të KKSH nga shtyllat e tensionit, trafo 0.4kv tokësore	m	30.00	3.00	90.00 €
2.8	Mihja e kanalit për shtrirjen e kabllos tokesore me dimenziione 75x50cm si dhe mbulimi pas vendosjes te kabllos në kanal të bëhet rrafshimi dhe ngjeshja e dheut.	m <sup>1</sup>	20.00	4.00	80.00 €
2.9	Furnizimi dhe vendosja e shiritit të zinguar për tokzim Fe/Zn 25*3mm	m	20.00	2.00	40.00 €
3	Furnizimi dhe vendosja e gypit PVC FI 50 pë kabillon furnizuese	m	20.00	1.50	30.00 €
3.1	Matja e tokëzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokëzimit	copë	2.00	150.00	300.00 €
3.2	Montimi i kabilove ne shtyllat e tensionit elektik	copë	2.00	20.00	40.00 €
3.3	Porositja ,furnizimi transporti dhe shtrirja e shiritit paralajmerues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit.	m	20.00	0.50	10.00 €
3.4	Sonda pertokezuese Ø75mm/1500mm	copë	2.00	6.00	12.00 €
3.5	Porositja, furnizimi, transporti dhe shtrirja e e rrërs se imet në kanalin me dimenziione (0.5x0.75)cm dhe me gjatesi 470 m ne nivelin 20 cm.	m <sup>3</sup>	2.00	15.00	30.00 €
3.6	furnizimi dhe montimi i lirave me gjatësi 0.7m me këndin 15 shkallë ndërtuar sipas standartit ISO UN EN ISO 1461 standard i i zingimit. e galvanizuar .	copë	110.00	18.00	1,980.00 €
3.7	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te betoni të tensionit të ulët TU me gjatësi 9 M „loji shp , 9/315	copë	12.00	240.00	2,880.00 €
3.8	Furnizimi dhe vendosja e kabllos bistek ajrore përfundimtës trupave ndriçuese 2x16mm <sup>2</sup> (AL) prej shtyllës në shyllë	m <sup>1</sup>	4,000.00	1.30	5,200.00 €
3.9	Furnizimi dhe montimi i hallkave (unazave) me material të qelikut të zinguar, përfundimtës e kabllos në shtyllë të , betonit.	copë	110.00	3.00	330.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i shtërgueseve têrheqëse (fundorëve) për kablo elektrike ajrore bistek 2x16mm <sup>2</sup> (AI)	copë	220.00	2.00	440.00 €
4.1	Dernolimi i rrjetit të vjetër egzistues ku përfshihet kabillo,lionferi i zhveshur i ndriçimit publik,komplet me poqa joefiqent dhe paisje tjera.Bartja dhe transporti deri në deponi.	m <sup>1</sup>	3,500.00	1.00	3,500.00 €
4.2	Furnizimi dhe montimi i klemëve përfundimtës, lidhjene e kabllos	copë	220.00	2.00	440.00 €
4.3	Evidentimi i instalimeve nëntokësore,riparim i tyre pas dëmtimit gjatë punës dhe këthim në gjendje të mëparëshme funksionale.	komp let	1.00	350.00	350.00 €
4.4	Hartimi i projektit detal nga ana e kompanisë ,pas përfundimit të projektit „ASB Draïeng„, duke përfshirë të gjitha elementet përcjellëse ,furnizuese,montuese .zbatuese.	m <sup>1</sup>	3,500.00	1.00	3,500.00 €
4.5			Totali		34,048.40 €
<b>Rekapitullim</b>					
1	<b>Punët paraprake në terren.</b>				3,500.00
2	<b>Rinkostruimi i ndriçimit publik në fshatin Janjeve</b>				34,048.40
	<b>Totali komplet</b>				37,548.40

Paramasa - Ndriçimi publik rruga 6 Maji Gadime e Ulët					
Pos	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Gjithsej me TVSH
1	<b>PUNET PARAPRAKE NE TEREN</b>				
1.1	Shenimi i trasesë, si dhe perçellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m <sup>2</sup>	970.00	0.50	485.00 €
1.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë zhvillimit të punimeve përgjat trasese .	m <sup>2</sup>	970.00	0.50	485.00 €
				gjithsej	970.00 €
2	<b>PUNËT E NDRIÇIMIT</b>				
	Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të janë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e qualitetit dhe te standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. OE është i obliguar qe t'i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të janë plotësisht të njëjta me të dhënat teknike të përshtkuara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikaten e origjinës së materialeve. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet tia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim.				
2	<b>Ndriçimi publik rruga 6 Maji Gadime e Ulët</b>				
	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Gjithsej me TVSH
2.1	Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriçimit KESHN nga materiali i metallit i ngjyrosur me ngjyrë antikorodive me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës trekëndësh (univerzal).. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadë duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozioni. Kuadri duhet të përbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente: 1. Njehsorin elektrik trefazor digjital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarifor 3x230/400V; 50Hz i miratuar nga MTI 2. Ndërpresë automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A 4. Siguresat automatiqe katëropolare 32A ; - " " 16A ; - " " 6A 5. Kontaktori për kyje automatiqe të ndriçimit C-44 ,40A,380V 6. Releun kohore digital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriçimit ,me bazhdarim me kohë.dhe kyje me errësirë. 8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në fazë 9. Prizën njëpolare për shërbime e servisime brenda kuadrit 10. Llambën ndiquese në brendi të kuadrit 11. Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përqesve në fazë, zbarren e përqesve të zeros dhe zbarren e përtokzimit, 12. Shkarkuesit katodik dhe zbarren për barazimin e potencialit.13.Siguresat thikore 63 A ,3 copë; Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të janë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriçimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elementeve duhet të behet ne baze te skemes njekahore e kuadrit shperndares.	copë	2.00	510.00	1,020.00 €
2.2	Ndërtimi i bazamentit të betonit për KKSH të ndriçimit me dimenzione 80x90x30cmx1	m <sup>3</sup>	0.44	60.00	26.40 €

2.5	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 50E me llupë.Llampa nga aspekti i dizajnit duhet ti plotësojë standartet Europeane, EN 60598-2-3,EN 55015 DHE TË KETË; Mbrojtëje : IP65(IP66).Qëndrueshmëri pune :≥50000(h) Efikasitet ndriçueshmërisë së LEDIT-IT≥125LM/ë Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:≤5000K Tension pune :90... 270V (50Hz) Faktor të Fugjes:≥0.92 Temperaturë pune:(-40 ..+60)°C Mbrojtëje nga goditja:IK10 Garancion :≥ 5 vite.		copë	50.00	125.00	6,250.00 €
2.6	Furnizimi dhe montimi i kabllosë furnizuese NAYY -AL-4X25mm <sup>2</sup> ,për furnizim të KKSH nga shtyllat e tensionit, trafo 0.4kv tokësore	m	30.00	3.00	90.00 €	
2.8	Mihja e kanalit për shtrirjen e kabllos tokesore me dimennzione 75x50cm si dhe mbulimi pas vendosjes te kabllos në kanal të bëhet rrashimi dhe njjesha e dheut.	m	20.00	4.00	80.00 €	
2.9	Furnizimi dhe vendosja e shiritit të zinguar për tokzim Fe/Zn 25*3mm	m	20.00	2.00	40.00 €	
3	Furnizimi dhe vendosja e gypit PVC Fl 50 për kablon furnizuese	m	20.00	1.50	30.00 €	
3.1	Matja e tokëzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokëzimit	copë	2.00	150.00	300.00 €	
3.2	Montimi i kabllove ne shtyllat e tensionit elektrik	copë	2.00	20.00	40.00 €	
3.3	Porosita , furnizimi transporti dhe shtrirja e shirtit paralajmerues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit.	m	20.00	0.20	4.00 €	
3.4	Sonda pertokezuese Ø75mm/1500mm	copë	2.00	6.00	12.00 €	
3.5	Porosita, furnizimi, transporti dhe shtrirja e e rërës se imet në kanalin me dimenzone (0.5x0.75)cm dhe me gjatesi 470 m ne nivelin 20 cm.	m <sup>3</sup>	2.00	15.00	30.00 €	
3.6	furnizimi dhe montimi i lirave me gjatësi 0.7m me këndin 15 shkallë ndërtuar sipas standardit ISO UN EN ISO 1461 standard i i zingimit. e galvanizuar .	copë	50.00	18.00	900.00 €	
3.7	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te betoni të tensionit të ulët TU me gjatësi 9 M ,loji shp , 9/315	copë	15.00	240.00	3,600.00 €	
3.8	Furnizimi dhe vendosja e kabllos bistek ajrore për furnizimin e trupave ndriçuese 2x16mm <sup>2</sup> (Al.) prej shtylle në shyllë	m <sup>1</sup>	1,050.00	1.30	1,365.00 €	
3.9	Furnizimi dhe montimi i hallkave (unazave) me material të qelikut të zinguar, përforsimini e kabllos në shtyllë të , betonit.	copë	50.00	3.00	150.00 €	
4	Furnizimi dhe montimi i shtërngueseve tërheqëse (fundorëve) për kablo elektrike ajrore bistek 2x16mm <sup>2</sup> (Al)	copë	100.00	2.00	200.00 €	
4.1	Furnizimi dhe montimi i klemëve për shtërngimin, lldhjene e kabllos	copë	100.00	2.00	200.00 €	
4.2	Evidentimi i instalimeve nëntokësore,riparim i tyre pas dëmtimit gjatë punës dhe këthim në gjendje të mëparëshme funksionale.	komp let	1.00	350.00	350.00 €	
4.3	Hartimi i projektit detali nga ana e kompanisë ,pas përfundimit të projektit „ASB Dralëng,, duke përfshirë të gjitha elementet përcjellëse ,furnizuese,montuese .zbatuese.	m <sup>1</sup>	970.00	1.00	970.00 €	
4.4				Totali	15,657.40 €	
<b>Rekapitullim</b>						
1	<b>Punët paraprake në terren.</b>				970.00	
	<b>Ndriçimi publik rruga 6Maij Gadime e Ulët</b>				15,657.40	
	<b>Totali komplet 6 maji Gadime e Ulët</b>				16,627.40	
	<b>Ndriçimi publik i rrugës në fshatin Janjevë</b>				37,548.40	
	<b>Totali komplet rruga 6 maji dhe rrugët në fshatin Janjevë</b>				54,175.80	

## KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

# NJOFTIM PËR KONTRATË

PUNË

FURNIZIM

SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 27.09.2024

Nr i Prokurimit	613-24-10149-5-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip

Serbisht

Anglisht

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN		
Adresa Postare: SHQIPERIA		
Qyteti: LIPJAN	Kodi postar: 14000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Bekim Shabani		Telefoni: 038 200 41539
Email: Bekim.g.shabani@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Po  Jo

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po  Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

*Nëse po*, specifiko identitetin e të gjithë Autoritetave Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referojnë një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## **II.1) PËRSHKRIMI**

### **II.1.1) Titull i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**

Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët.

### **II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

